



Pranimi / Doretuar Prilidjen / Prodato Received / Delivery	10.10	2022	2	vit god year
Organ / Njësia Organ / Jednitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Protit Zependa	Sasia Koliciteti Quantity	
SHMESHDA	6049/2022		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.229/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.313/2022 të datës 06.09.2022, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.229/2019 të datës 04.04.2019 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat më adresë

kundër Vendimit me Nr. Prot: 02-150/02-2497/19 të datës 18.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpcës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.229/2022 e datës 04.04.2019 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 02-150/02-2497/19 i datës 18.03.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpcës.
- III. Anullohet formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për vitin 2018 i datës 10.01.2019.
- IV. Obligohet Kryetari I Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtërpcës, që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi Brenda 15 ditësh nda dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas Akt Emërimit me Nr. 02-16-1913 të datës 01.07.2013, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës, dhe duke bërë kompensimin e pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar sipas Akt Emërimit Të datës 01.07.2013 në pozitën Teknik i Pylltarisë në Komunën e Shtërpçës, më datë 20.12.2017 nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë është vlerësuar për rezultatet në punë me notë të përgjithshme 1.05, ndërsa më datë 10.01.2019 është vlerësuar me notë të përgjithshme 1.25. Si rezultat i vlerësimeve Menaxheri i Personelit i Komunës së Shtërpçës më datë 12.02.2019 ka nxjerr Aktvendim me Nr. 02-030/01-1804/19 përmes të cilin ankuesit i në ndërprerë marrëdhënien e punës. Ankuesi kundër këtij aktvendimi më datë 28.02.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpçës.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpçës më datë 18.03.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-150/02-2497/19 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesin kundër këtij vendimi, më datë 04.04.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1743/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për zbatim të gabuar të drejtës materiale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje e procedurës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtërpçës. Ndërsa Këshilli më datë 03.05.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 22.03.2022 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 06.09.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.313/2022 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 04.04.2019 të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:1743/2019 të datës 04.04.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin me Nr. 02-030/01-1804/19 të datës 12.02.2019 të Menaxheres së Personelit të Komunës së Shtërpçës, Vendimin për përmirësimin e gabimit i datës 29.03.2019; Vendimin me Nr. 02-150/02-2497/19 të datës 18.03.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpçës;



Ankesën e datës 28.02.2019 të ankuesit; Formatuarin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 10.01.2019 dhe 20.12.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2019; Përgjigjen në ankesë 03.05.2019; Akt Emërimit e datës 01.07.2013 të ankuesit; Formatuarin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 24.12.2016; Vërejte me shkrim e datës 01.10.2014; Vërejtën me shkrim me Nr. 85-16-6665; Kërkesën për njoftim lidhur me ankesën e datës 04.04.2019 nga ankuesi e datës 01.02.2022; Përgjigjen e datës 22.03.2022; Autorizimin e përgjithshëm i datës 26.01.2022; Aktgjykimin A.nr.313/2022 i datës 06.09.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesë për prova shtesë e datës 20.09.2022 për dhe Përgjigjen e datës 28.09.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi me Nr. 02-150/02-2497/19 i datës 18.03.2022 dhe datës 29.03.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpçës, pretendon që ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të kundërligjshme sepse në aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës është aplikuar gabimisht e drejta materiale sepse janë përdorur masat disiplinore vërejtje me shkrim të vitit 2014 e të cilat sipas ligjit janë shuar pasi një viti, tek vlerësimi i rezultateve në punë janë aplikuar gabimisht dispozitat e Rregullores Nr. 19/2019 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës për Nëpunësit Civil, kështu që të gjitha vendimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë të kundërligjshme.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së ankuesit konkretisht Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Sa i përket masave disiplinore vërejtjeve me shkrim të shqiptuar ndaj ankuesit në vitin 2014, Kolegji i Këshillit, konstaton se masa disiplinore vërejtje me shkrim konsiderohet masë e lehtë e përcaktuar me nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ndërsa masa e tillë shuhet brenda një viti nga dita e dhënies së tyre siç parashihet me paragrafi 3 të nenit 7 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, rrjedhimisht pas një viti kur vërejtjet me shkrim ndaj ankuesi janë shqiptuar të njëjtat nuk janë në fuqi dhe nuk prodhojnë pasoja juridike.

Si rezultat i kësaj, Menaxheri i Personelit i Komunës së Shtërpçës me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit me Nr. 02-030/01-1804/19 të datës 12.02.2019 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit, si rrethanë i është referuar edhe masës disiplinore vërejtje me shkrim të datës 10.10.2014, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se aplikimi i një rrethane të tillë është shkelje ligjore e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, po ashtu është shkelje e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Lidhur me formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin, të vitit 2018 i cili është nënshkruar nga vlerësues më datë 10.01.2019, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, është përcaktuar se: *“Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:1.5. Periudha e vlerësimit, nënkupton periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë dhe zgjat nga 1-31 dhjetor të vitit të vlerësuar”*, ndërsa në bazë të provave materiale, vlerësimi i rezultateve në punës për ankuesin është bërë më datë 10.01.2019, jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e lartcekura, si i tillë është i pavlefshëm.

Po ashtu sa i përket vlerësimi të rezultateve në punës për vitin 2018 i cili është nënshkruar nga vlerësues më datë 10.01.2019, Kolegji i Këshillit, konstaton se *për çdo objektiv apo aftësi të nëpunësit civil të vlerësuar me notat 1, 4 dhe 5, vlerësuesi duhet të arsyetojë vendimin e tij, përmes plotësimit të pjesës së komenteve në formularin e vlerësimit*, siç parashihet me nenin 10 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, nisur nga këto Kolegji, konstaton se ky vlerësim bëhet i pavlefshëm në kuptim të këtyre dispozitave për shkak që ka shkelje esenciale të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Sa i përket vlerësimi të ligjshmërisë së Aktvendimit me Nr. 02-030/01-1804/19 të datës 12.02.2019 të Menaxheres së Personelit të Komunës së Shtërpcës, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se nga të lartcekurat ky vendim është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të aplikueshëm si më lartë dhe i njëjti është nxjerr me konstatim të gabuar të gjendjes faktike, vlerësim të pa argumentuar të provave materiale dhe i njëjti është në kundërshtim të plotë me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr. 02-150/02-2497/19 i datës 18.03.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpcës, është nxjerr në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe juridike, sepse me këtë vendim është vërtetuar një akt administrativ i nxjerr nga Menaxheri i Personelit që ka qenë i kundërligjshëm për arsyet e sipër cekura.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji i Këshillit meqë konstaton se Aktvendimi me Nr. 02-030/01-1804/19 i datës 12.02.2019 i Menaxheres së Personelit të Komunës së Shtërpcës, Vendimi me Nr. 02-150/02-2497/19 i datës 18.03.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtërpcës, janë nxjerr në kundërmim me legjislacionin në fuqi të njëjtat janë të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Kolegji i Këshillit, konstaton që organi i punësimit respektivisht Kryetari I Komunës dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtërpcës, në pajtim me këtë vendim janë të obliguar që ankuesin ta kthejnë në vendin e tij të punës sipas Akt Emërimit me Nr. 02-16-1913 të datës 01.07.2013, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga

marrëdhënia e tij e punës, dhe duke bërë kompensimin e pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.229/2019

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës



Malsorë Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit.
- Kryetarit të Komunës së Shtërpcës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Komunës së Shtërpcës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së





Pranuar / Dorezuar Punigjenor/Prodato Received/Delivered	10.10.2022	2	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Rr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKPM SHK	6049/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.br.229/2019

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova – Veće za razmatranje i rešavanje žalbi u sastavu: Malsore Gashi-Bajraktari, Arben Mehmeti i Ardita Haxhnikaj-Demi-članovi i Avdyl Bekteshi- viši službenik za stručnu saradnju, na osnovu Presude A.br.313/2022 od dana 06.09.2022.godine, razmotrilo je žalbu broj A.br.229/2019 od dana 04.04.2019.godine podneta od žalioca kojeg uz ovlašćenje zastupa advokat protiv Odluke br. Prot: 02-150/02-2497/19 od dana 18.03.2019.godine doneta od Komisije za rešavanje sporova i žalbi u opštini Štrpce, po pravnoj stvari “prekid radnog odnosa” postupajući u skladu sa članom 6. stav 1. podstav 1.1. i članom 18. stav 1 podstav 1.2 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova i Pravilnika br.02/2018 o Pravilima i Žalbenim procedurama u Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, na sednici za savetovanje i glasanje, dana 10.10.2022.godine, donosi ovu:

O D L U K U

- I. Usvaja se kao osnovana** žalba broj A.br.229/2022 od dana 04.04.2019.godine podneta od žalioca
- II. Stavlja se van snage** Odluka br.02-150/02-2497/19 od 18.03.2022.godine doneta od Komisije za rešavanje sporova i žalbi u opštini Štrpce.
- III. Poništava se** formular o vrednovanju rezultata rada za žalioca za 2018.godinu od dana 10.01.2019.godine.
- IV. Obavezuje se** predsednik opštine i rukovodilac Jedinice za ljudske resurse u opštini Štrpce da sprovedu ovu odluku u roku od 15 dana od dana njenog primanja, vraćajući podnosioca žalbe na njegovo radno mesto u skladu sa Aktom o imenovanju br.02-16-1913 od 01.07.2013.godine, sa svim pravima i obavezama iz radnog odnosa, uz ostvarivanje nadoknade plata od dana prekida radnog odnosa do izvršenja ove odluke.
- V. Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova** treba pismeno obavestiti nakon preduzimanja radnji u skladu sa ovom odlukom.

O b r a z l o ž e n j e

Podnosioc žalbe zaposlen shodno Aktu o imenovanju od 01.07.2013.godine na radnom mestu- Šumarski tehničar u opštini Štrpce, dana 20.12.2017.godine, od njegovog neposrednog rukovodioca ocenjen za rezultate rada sa ukupnom ocenom 1,05, dok je dana 10.01.2019 je ocenjen ukupnom ocenom 1,25. Kao rezultat ocena, kadrovski rukovodilac u opštini Štrpce, 12.02.2019.godine doneo je Rešenje br.02-030/01-1804/19 kojim je podnosiocu žalbe prekinuo radni odnos. Protiv ovog rešenja žalioc je 28.02.2019.godine podneo žalbu Komisiji za rešavanje sporova i žalbi u opštini Štrpce.

Komisija za rešavanje sporova i žalbi u opštini Štrpce, dana 18.03.2019.godine donela je Odluku br.02-150/02-2497/19 kojom je žalbu podnosioca žalbe odbila.

Protiv ove odluke, podnosilac žalbe podneo je žalbu dana 04.04.2019. broj prot:1743/2019 u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, navodeći o pogrešnoj primeni materijalnog prava, pogrešnom i nepotpuno utvrđenom činjeničnom stanju i povredi postupka.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, na osnovu Pravilnika br.02/2018 o Proceduri razmatranja i rešavanja žalbi u Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, žalbu podnosioca žalbe procesuirao je u opštinu Štrpce, radi dobijanja odgovora na žalbu. Dok je dana 03.05.2019.godine, Odbor dobio odgovor na žalbu.

U nedostatku kvoruma za odlučivanje, Odbor je 22.03.2022.godine, Odbor je obavestio podnosioca žalbe o razlozima nerazmatranja žalbe i uputio istog da prati dalje procedure u skladu sa Zakonom o upravnim sporovima. Podnosilac žalbe je, u nedostatku kvoruma za odlučivanje, pratio sudske procedure i kao rezultat toga pokrenuo je upravni spor u Osnovni sud u Prištini/Odeljenje za administrativne poslove.

Osnovni sud u Prištini/Odeljenje za administrativne poslove, dana 06.09.2022.godine doneo je Presudu A.br.313/2022 kojom je obavezao Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova da razmotri i odluči u vezi žalbe od 04.04.2019.godine podnete od žalioca.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, u cilju potpunog i pravednog utvrđivanja činjeničnog stanja, za donošenje meritorne odluke, utvrdilo je sledeće dokaze: Žalbu broj Prot:1743/2019 od 04.04.2011.godine, podnete u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova; Odluku br.02-030/01-1804/19 od 12.02.2019.godine doneta od kadrovskog rukovodioca opštine Štrpce; Odluku o ispravci greške od 29.03.2019.godine; Odluku br.02-150/02-2497/19 od 18.03.2022.godine doneta od Komisije za rešavanje sporova i žalbi u opštini Štrpce; Žalbu podnosioca žalbe od 28.02.2019.godine; Formular o vrednovanju rezultata rada za podnosioca žalbe od 10.01.2019. godine i 20.12.2017.godine; Zahtev za odgovor na žalbu od 15.04.2019.godine; Odgovor na žalbu 03.05.2019.godine; Akt o imenovanju podnosioca žalbe od 01.07.2013.godine; Formular o vrednovanju rezultata rada podnosioca žalbe od 24.12.2016.godine; Pismenu opomenu od 01.10.2014.godine; Pismenu opomenu br.85-16-6665; Zahtev za obaveštenje u vezi sa žalbom od 04.04.2019.godine podnosioca žalbe od 01.02.2022.godine; Odgovor od 22.03.2022.godine; Opšte ovlašćenje od 26.01.2022.godine; Presudu A.br.313/2022 od 06.09.2022.godine donetu od Osnovnog suda u Prištini-Odeljenje za administrativne poslove; Zahtev za dodatnim dokazima od 20.09.2022.godine za Odgovor od 28.09.2022.godine.



Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, nakon što je razmotrilo sve spise predmeta koje su podnele stranke, utvrdilo je da je žalba podnosioca žalbe **osnovana**, jer:

Podnosilac žalbe u žalbi podnetoj Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, protiv Odluke br.02-150/02-2497/19 od 18.03.2022.godine i od **dana 29.03.2022.godine** Komisije za rešavanje sporova i žalbi opštine Štrpce, tvrdi da je prekid radnog odnosa urađen nezakonito, jer je u rešenju o prekidu radnog odnosa, pogrešno primenjeno materijalno pravo, jer su korišćene disciplinske mere pismena opomena iz 2014.godine, koje su po zakonu ugašene nakon godinu dana, kod vrednovanja rezultata rada, pogrešno su primenjene odredbe Uredbe br.19/2019 o Vrednovanju rezultata rada za civilne službenike, tako da su sve odluke o prekidu radnog odnosa nezakonite.

U cilju razmatranja žalbenih tvrdnji podnosioca žalbe, Veće Odbora analizirao je zakonske odredbe na snazi u vreme prekida radnog odnosa podnosioca žalbe, konkretnije Zakon br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i podzakonske akte za sprovođenje ovog zakona. Što se tiče disciplinskih mera pismenih opomena izrečenih podnosiocu žalbe u 2014.godini, Veće Odbora konstatuje da se disciplinska mera pismena opomena smatra lakšom merom propisana u članu 7. stav 1. stav 1.2 i 1.3 Uredbe br.04/2011 o Disciplinskim procedurama u civilnoj službi, dok se takva mera gasi u roku od godinu dana od dana njenog izricanja, kao što je propisano u stavu 3. člana 7. Uredbe br.04/2011 o Disciplinskom postupku u civilnoj službi, shodno tome nakon godinu dana, kada su izrečene pismene opomene protiv žalioaca, iste nisu na snazi i ne proizvode pravne posledice.

Kao rezultat toga, kadrovski rukovodilac u opštini Štrpce, prilikom donošenja Rešenja br.02-030/01-1804/19 od 12.02.2019.godine o prekidu radnog odnosa žalioacu, kao okolnost pozvao se i na disciplinsku meru od 10.10.2014.godine, pa stoga Veće Odbora zaključuje da je primena takve okolnosti zakonsko kršenje propisano Zakonom br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Uredbom br. 04/2011 o Disciplinskom postupku u civilnoj službi, takođe je kršenje Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, tako da je tvrdnja podnosioca žalbe osnovana.

Što se tiče formulara o ocenjivanju rezultata rada podnosiocu žalbe za 2018.godinu, koji je potpisao ocenjivač dana 10.01.2019. godine, Veće Odbora zaključuje da shodno članu 3. stav 1 podstav 1.5 Uredbe br.19/2012 o Vrednovanju rezultata rada civilnih službenika, propisano je da: „*Za potrebe ove Uredbe, sledeći termini imaju ovo značenje: 1.5. Period ocenjivanja podrazumeva period u kome se sprovodi postupak ocenjivanja rezultata rada i traje od 1. do 31. decembra za godinu ocenjivanja*“, dok je na osnovu materijalnih dokaza, vrednovanje rezultata rada za podnosioca žalbe urađeno 10.01.2019.godine, što je izvan roka utvrđenog navedenim odredbama, i kao takav je nevažeće.

Takođe, što se tiče vrednovanja rezultata rada za 2018.godinu, koju je ocenjivač potpisao 10.01.2019.godine, Veće odbora konstatuje da *za svaki cilj ili sposobnost civilnog službenika ocenjen ocenom 1, 4 i 5, ocenjivač treba da obrazloži svoju odluku, popunjavanjem dela za komentare u formularu za ocenjivanje*, kako je predviđeno članom 10. stav 3. Uredbe br.19/2012 o Vrednovanju rezultata rada civilnih službenika, na osnovu toga, Veće zaključuje da ova ocena postaje nevažeća u smislu ovih odredbi, jer postoji suštinsko kršenje važećih zakonskih odredbi.

Što se tiče ocene zakonitosti Rešenja br.02-030/01-1804/19 od 12.02.2019. godine donet od kadrovskog rukovodioca opštine Štrpce, u vezi prekida radnog odnosa podnosiocu žalbe, Veće Odbora zaključuje da je iz gore navedenog, ova odluka doneta je u suprotnosti sa gore važećim zakonskim odredbama, i ista je doneta sa pogrešno utvrđenim činjeničnim stanjem, neargumentovanom ocenom materijalnih dokaza i ista je u potpunosti suprotnosti sa članom 48. Zakona br.05/L-31 o Opštem upravnom postupku.



Takođe, Veće Odbora zaključuje da je Odluka br.02-150/02-2497/19 od 18.03.2022.godine doneta od Komisije za rešavanje sporova i žalbi opštine Štrpce, doneta u suprotnosti sa Zakonom br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova, Uredbom br.05/2011 o Procedurama rešavanja sporova i žalbi i Zakonom br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, jer nije pravedno utvrđeno činjenično i pravno stanje, jer je ovom odlukom potvrđen jedan upravni akt izdat od strane kadrovskog rukovodioca koji je bio nezakonit iz gore navedenih razloga.

Na osnovu gore navedenog, Veće Odbora konstatuje da su Rešenje br.02-030/01-1804/19 od 12.02.2019. godine, doneto od kadrovskog rukovodioca opštine Štrpce, Odluka br.02-150/02-2497/19 od 18.03.2022.godine Komisije za rešavanje sporova i žalbi opštine Štrpce, doneti u suprotnosti sa važećim zakonodavstvom, isti su nezakoniti u smislu člana 52. stav 1 podstav 1.3, 1.5 i 1.6 Zakona br. 05/L-31 o Opštem upravnom postupku, tako da su sve tvrdnje podnosioca žalbe osnovane.

Veće Odbora konstatuje da su organ za zapošljavanje, odnosno predsednik opštine i rukovodilac Jedinice za ljudske resurse u opštini Štrpce, u skladu sa ovom odlukom, dužni da žalioca vrata na njegovo radno mesto u skladu sa Aktom o imenovanju br.02-16-1913 od 01.07.2013.godine, sa svim pravima i obavezama iz radnog odnosa, uz ostvarivanje nadoknade plata od dana prekida radnog odnosa do sprovođenja ove odluke.

Na osnovu ovih okolnosti, Veće za rešavanje i odlučivanje žalbi, nakon analiziranja i ocene svih predmetnih spisa i na osnovu nadležnosti Odbora i člana 18 stav 1 podstav 1.2 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, odlučilo kao u dispozitivu ove odluke.

Odluka stupa na snagu danom potpisivanja od strane predsednice Veća.

Pravna pouka: Protiv odluke Odbora, nezadovoljna stranka koja tvrdi da je odluka Odbora nezakonita, može pokrenuti upravni spor u Osnovni sud u Prištini- Odeljenje za administrativne poslove u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje ove odluke.

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILE SLUŽBE KOSOVA
Predmet broj A.br.229/2019

Avdyl BEKTESHI

Zapisničar

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Predsednica Veća

Odluku dostaviti:

- Zastupniku žalioca advokatu
- Predsedniku opštine Štrpce;
- Kadrovskom rukovodiocu Sekretarijata opštine Štrpce i
- Arhivi NNOCSSK-a

Preveo:

Sh. Mujko

Dana, 10.10.2022.god.